



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



---

## THIRRJE PËR APLIKIM

Komuna e Prishtinës – Drejtoria e Bujqësisë, me qëllim të rritjes së transparencës dhe duke u bazuar në Rregulloren për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Prishtinës, hap Thirrje për katër përfaqësues të shoqërisë civile apo përfaqësues të institucioneve arsimore në fushën e bujqësisë si pjesëmarrës në procesin e vlerësimit të grantëve dhe subvencioneve në sektorin e bujqësisë për vitin 2026.

**Për të përzgjedhur përfaqësues të shoqërisë civile apo përfaqësues të institucioneve arsimore me përvojë në fushën e bujqësisë, në cilësinë e anëtarëve të Komisionit për vlerësimin e procesit të dhënies së granteve dhe subvencioneve, ftohen OShC-të apo përfaqësues të institucioneve arsimore aktivë në fushën e bujqësisë në Kosovë që të nominojnë përfaqësuesit e tyre.**

### KRITERET PËR ORGANIZATAT QË NOMINOJNË KANDIDATËT

Të drejtën për të nominuar kandidatë kanë të gjitha OShC-të apo përfaqësues të institucioneve arsimore me provoj në fushën e bujqësisë që:

- Janë të regjistruara sipas Ligjit për Liri të Asocimit në Kosovë;
- Përfaqësues të institucioneve arsimore që kanë së paku 3 vite përvojë në fushën e bujqësisë.

Për të qenë pjesë e komisionit përkatës, OShC-të apo përfaqësuesit e institucioneve arsimore, 4 (katër) kandidatët (prej tyre 2 rezervë) duhet të plotësojnë kriteret në vijim:

- Të jenë profesorë/e ose mësimdhënës/e në shkollë të mesme profesionale të bujqësisë;
- Të jenë ligjërues/e ose asistentë/e në institucione të arsimit të lartë në fushën e bujqësisë;

- Të jenë inxhinierë/e të diplomuar në bujqësi (agronomë/e) me përvojë praktike në sektor;
- Të jenë ekspertë/e ose këshilltarë/e në sektorin e bujqësisë (publik apo privat);
- Të jenë përfaqësues/e të organizatave që merren drejtpërdrejt me zhvillimin rural dhe bujqësor;
- Të jenë shtetas/e të Republikës së Kosovës;
- Të kenë kualifikim në fushën e bujqësisë së paku (BA/MSc);
- Të kenë përvojë pune në shoqëri civile ose përfaqësues të institucioneve arsimore në fushën e bujqësisë, minimumi 6 muaj;
- Të mos kenë qenë të angazhuar në 5 vitet e fundit në Drejtorinë e Bujqësisë në Komunën e Prishtinës ;
- Angazhimi është në baza vullnetare dhe nuk kompensohet financiarisht;
- Kandidatët e përzgjedhur do të jenë pjesë e komisionit për vlerësimin e aplikacioneve për grande dhe subvencione në sektorin e bujqësisë;
- Kandidatët e përzgjedhur obligohen që nga momenti i emërimit nga Kryetari i Komunës, të jenë aktivë gjatë gjithë procesit të përzgjedhjes së përfituesëve;
- Mos pjesëmarrja në shqyrtimin administrativ të aplikacioneve dhe në vizitat në terren, pa ndonjë arsye të justifikuar, nënkupton moszbatim të përgjegjësive të marra.

### **Procedurat e nominimit**

Të gjitha organizatat e shoqërisë civile apo përfaqësues të institucioneve arsimore që i plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë thirrje ftohen të nominojnë kandidatët e tyre përmes dorëzimit të dokumentacionit përkatës.

Nominimet duhet të dërgohen në formë elektronike në adresën zyrtare:

**arjana.saraci@rks-gov.net**, e administruar nga zyrtarët e komisionit përkatës të Kryeqytetit.

### **Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

Organizatrat nominuese duhet të dorëzojnë:

- Një përshkrim të shkurtër të portofolios dhe përvojës së organizatës në fushën përkatëse;
- CV-në e personit të nominuar;
- Certifikatën e regjistrimit të organizatës.

### **Procesi i përzgjedhjes**

- Në rast se numri i kandidatëve që i plotësojnë kriteret tejkalon numrin e vendeve të parashikuara, do të zhvillohet një proces përzgjedhjeje;
- Nominimet do të shqyrtohen nga një komision i përbashkët i përbërë nga përfaqësues të Kryeqytetit;
- Kandidatët e përzgjedhur do të njoftohen zyrtarisht përmes email-it.

**Nominimi mbetet i hapur nga data 07.04.2026 deri me datën 14.04.2026**